



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Nr.1, Tiranë

E-mail: klsh@org.al web-site: www.klsh.org.al

Nr. 339/Prot.

Tiranë, më 30/3/2020

URDHËR

Nr. 43, datë 30/3/20

PËR

HEDHJEN NË RevZone TË DOKUMENTEVE TË AUDITIMIT

Bazuar në ligjin nr.154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; Urdhrit nr.151, datë 29.10.2018 "Për fillimin e veprimtarisë audituese nëpërmjet përdorimit të sistemit të informacionit për menaxhimin dhe mbështetjen e proceseve të auditimit", si dhe në Kujtesën e datës 13.03.2020 me nr. extra të prot., me qëllim dokumentimin e veprimtarisë audituese dhe trajnuese gjatë muajit Mars,

URDHËROJ:

1. Të gjithë Drejtorët e Departamenteve të Auditimit, Kryeaudituesit, Përgjegjësit grupeve dhe audituesit të hedhin në RevZone dokumentet e auditimit që kanë në proces, si: Akt konstatime, Akt verifikime, Projekt Raporte dhe Raporte Përfundimtare etj., sipas stadiit përkatës të auditimit.
2. Përgjegjësit e grupeve të hedhin në RevZone Informacionet mbi ecurinë e auditimeve që janë në proces, duke krijuar akses për Drejtorët e Departamenteve për njohje dhe përgatitjen e Informacionit përmbledhës në nivel Departamenti.
3. Të hidhet në RevZone përmbledhje e ecurisë trajnuese që ka zhvilluar secili auditues përgjatë muajit Mars, sipas temave përkatëse.
4. Drejtoria e Metodologjisë dhe Trajnimeve të hedh në RevZone informacionin e plotë të trajnimeve, testeve dhe rasteve studimore të zhvilluara online.
5. Asistenca dhe mbështetja teknike do të sigurohen nga Drejtori i Departamentit të Auditimit IT z. Kozma Kondakçiu dhe Përgjegjësi i Sektorit IT z. Aldo Kita.
6. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohen Drejtorët/Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorët e Departamenteve/Drejtorive dhe stafi auditues.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI


Bujar LESKAJ